

VENDIM
Nr. 642, datë 22.11.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE
EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË
KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

1. Znj. Edona Bilali, ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zëvendësohet me znj. Delina Ibrahimaj, ministër i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

2. Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, zëvendësohet me znj. Almira Xhembulla, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku